

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje dru zjarri për nevojat e bashkise Maliq”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
03413000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

7.445.000 (shtatë milion e katërqind e dyzet e pesë mijë) pa tvsh

Vlera e fondit limit është përlogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”,neni 34 “Përlogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”,Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 12 “Metoda të zbatueshme në përlogaritjen e vlerës së kontratës”.Komisioni i përlogaritjes se fondit limit i ngritur me Urdher Titullari nr.607 prot date 05.12.2024 pasi ka bere nje studim te tregut ka gjetur oferta nga operatore ekonomike qe operojne ne kete fushe dhe ka llogaritur mesataren e cmimit te tregut duke nxjerre dhe fondin limit per proceduren.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për "Procedurës Tatimore "neni 64 Deklarata Tatimore.

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njërive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2024 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës, ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kesaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se disponon dokumentacionin shoqerues të lëndës drusore.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit i kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuar në mënyrë elektronike si më poshtë:

1. OE duhet te paraqese leje shfrytezimi per materialin drusor te shoqeruar me kontrate nga Institucionet Shteterore dhe sasia e prokuruar të jetë jo më pak se ajo që kërkohet në DST.

Ose

2. fatura tatimore shitje nga subjekte që kane lejen e shfrytëzimit e materialit drusor per furnizimin me dru zjari për sasinë që prokurohet.

Ose

3. Ne rastin e subjekteve te cilet jane tregtues te mallit (objekt prokurimi), nepermjet importit , te kene kontrate furnizimi dhe faturat doganore me subjekte te tjera qe importojne mallin objekt prokurimi

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë dokumentacionin e duhur per shfrytezimin e lendeve drusore sipas legjislacionit perkates..

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka 2(dy) makina transportuese, kamion me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 6-15 ton ,

“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit autoriteti kontraktor I kerkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuar ne menyre elektronike si me poshte:

a) Për mjetet ne pronesi:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

dhe per mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit te mallrave) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.jane kerkuar 2 kamiona me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 6-15 ton duke mare parasysh dhe sasine e druve qe do te transportohet sipas kerkeses se autoritetit kontraktor ne destinacion.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Keto mjete janë të nevojshme për të bërë transportin e sasisë së druve sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 9 ,një punësim mesatar i të paktën 4 (kater) punonjësve për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
Dhe
- b. **Listpagesat** e konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 4 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës shofer kamioni .
- 2 (dy) punonjës të thjeshtë

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit autoriteti kontraktor I kërkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorzimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuar në mënyrë elektronike si më poshtë:

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi

Argumentim: Pika 2.3.4 dhe pika 2.3.5 janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Jane kërkuar minimalisht 4 persona pasi janë të nevojshëm 2 shofer për 2 mjetet kamion që janë kërkuar, për transportin e druve dhe 2 punonjës të thjeshtë për shkarkimin në destinacionin e kërkuar.